



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 03.04.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 28.03.2024, të parashtruar nga Operatori ekonomik "DMAX EXPERT", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit-632-24-2227-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-027-221, nxjerr:

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "DMAX EXPERT", e dt.28.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Dezinfektimi, Dezinfektimi dhe Deratizimi në Komunën e Gjakovës", Nr. i prokurimit - 632-24-2227-2-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-027-221, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMIT PËR KONTRATË, të publikuar me datë 13.03.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Korigjohet** DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, i publikuar me datë: 13.03.2024;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëjë korigjimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë .
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Arsyetim

Operatori Ekonomik "DMAX EXPERT", me dt. 28.03.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi, instalimi dhe servisimi me kamera, projektor, TV, fotoaparate, Sistem zërimi, ndricim profesional", Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-24-1635-1-2-1, Nr. i brendshëm-632-24-014-121.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 03.04.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj i parë nuk qëndron sepse këto pajisje janë të obligueshme, pasi që është e pamundur që të bëjmë DDD pa pajisje përcjellëse;

Pretendimi juaj i dytë lidhur me specifikimet teknike të detyrueshme, mirret si i bazuar dhe në këtë pikë Autoriteti kontraktues do të bëjë korigjimin e dosjes së tenderit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Faton Gutaj


Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;